



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2023:277023

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05640546

**2023:282738**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni penal, Gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me sekretaren juridike Indira Beqa, në çështjen penale ndaj të pandehurit A.S nga fsh...-Kaçanik, i akuzuar për veprën penale, Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës PP/II.nr. 1872/23 të dt.14.12.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më datë 24.04.2024, në prezencë të Prokurorit të shtetit Avdulla Abedini, të dëmtuarit të mitur tani madhor, B. D. dhe të pandehurit, me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare, av.N.R., me dt.29.04.2024 mori dhe shpalli, ndërsa me dt.30.04.2024 përpiloi këtë:

### **A K T G J Y K I M**

I pandehuri A.S nga fsh... Komuna Kacanik , i lindur më dt... nga i ati R... dhe e ëma Xh... e gjinisë D... shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa martuar, shkollës e mesme , vozitës i autobusit , i gjendjes së mesme ekonomike, me nr.personal:...

### **ËSHTË FAJTOR**

Sepse me datë 19.08.2023 rreth orës 17:00h, në rrugën regjionale R-116 Ferizaj, derisa ka qenë duke e drejtuar autobusin e markës "...", ngjyrë e kaltër, me targa ..., prej fsh. Duraj-në drejtim të Fushës së Pajtimit, me të arritur përballë marketit " ..." në fshatin ..., komuna Kaçanik, i pandehuri nga pakujdesia ka rrezikuar jetën e njerëzve dhe pasurinë, në atë mënyrë që ka vepruar në kundërshtim me nenin 53 dhe 69 të Ligjit nr.05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, në atë mënyrë që duke mos treguar kujdes të posaçëm ndaj pjesëmarrësve të tjerë në komunikacion, dhe duke mos reaguar me kohë në mënyrë të duhur ndaj rrethanave të krijuara në trafik, ka ndërmarrë veprimin e tejkalimit të biçikletës, e cila ka qenë duke lëvizur pranë skajit të djathtë të rrugës, e drejtuar nga tani i dëmtuari-i mitur B. D., duke mos mbajtur distancë të mjaftueshme ndaj saj, dhe me atë rast ka ndodhur aksidenti ashtu që, pjesa e parme ballore e djathtë e autobusit e godet biçikletën në pjesën e pasme. Si pasojë e këtij aksidenti, përveq dëmit material, lëndime të rënda trupore, të përshkruara si në akt ekspertizën mjeko ligjore me numër të referencës 05/23 të datës 09.10.2023, ka pësuar drejtuesi i biçikletës-i dëmtuari B. D..

Me këto veprime, i pandehuri, A.S, ka kryer veprën penale, Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata, në bazë të nenit 2,7,38,44,69,70,71 par.1 nënpar.1.3 të KPRK-së, dhe nenit 358,359,360 dhe 364 të KPP-së, e

## **G J Y K O N**

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 ditësh, i cili dënim konfor nenit 44 të KPRK-së, i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 800.00 €.

I pandehuri është i obliguar që dënimin me gjobë t'a paguajë pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, në dy këste mujore, në afatin prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën, gjykata do t'a zëvendësoje dënimin me gjobë me dënim me burgim duke llogaritur shumën prej 20 € për çdo ditë burgimi.

Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës, të paguajë pranë kësaj gjykate shumë prej 170.00€, shumë prej 30.00€, në emër të paushallit gjyqësor, ndërsa për Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumë prej 20.00€, në afat të njëjtë me gjobën, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

I dëmtuari i mitur, tani madhor, B. D. nga fsh...-Kaçanik, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën: PP/II.nr. 1872/23 të dt.14.12.2023, e akuzoi të pandehurin A.S nga fsh...-Kaçanik, për veprën penale, Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që i njëjti të shpallet fajtor dhe të gjykohet sipas ligjit.

Në bazë të kësaj aktakuze, me dt.24.04.2024, gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar, me të cilin rast, prokurori i shtetit Avdulla Abedini me rastin e prezentimit të aktakuzës, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë aktakuzës së parshtruar me shkrim pranë kësaj gjykate.

I pandehuri në fjalën e tij në pyetjen e gjyqtarës deklaroi se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon akuza, për çka thot se pavarësisht se akcidenti ka ndodhur pa dashjen e tij e ndien veten keq për dëmin e shkaktuar të dëmtuarit, për shëndetin e të cilit është interesuar në vazhdimësi duke e vizituar edhe në spital edhe në shtëpi dhe duke i premtuar gjykatës se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm në vozitje për tu mos u përsëritur raste të tilla, prandaj edhe i kërkon gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit lidhur me këtë çështje penale t'i shqiptohet një dënim me gjobë, meqë edhe ashtu është hera e parë që ka shkaktuar një akcident trafiku.

Prokurori i shtetit në fjalën e tij, pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pasi që një pranim i tillë është bërë konform dispozitave ligjore të nenit 242 të KPP-së dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, duke i kuptuar benefitet dhe pasojat e këtij

pranimi, dhe një pranim i tillë ka mbështetje në provat dhe faktet në të cilat është mbështetur kjo aktakuzë, andaj i propozon gjykatës që të aprovojë pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit. Në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPK-së, gjykata me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit si rrethanë rënduese të merr parasysh shkallën e lartë të rrezikut-shkallën e përgjegjësisë penale, pasojën e shkaktuar në rastin konkret ku të dëmtuarit i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore, ndërsa si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, andaj i propozon gjykatës që të pandehurit t'i shqiptojë një dënim me gjobë në lartësi prej 1000.00 €.

Mbrojtësi i të pandehurit në fjalën e tij deklaroi se, pas konsultimeve me të mbrojturin e tij dhe pasi që të njëjtit i janë sqaruar pasojat dhe benifitet e pranimin të fajësisë, i njëjti e pranoi përgjegjësinë penale për veprën penale e cila i vihet në barrë, sipas aktit akuzues. Meqenëse ky pranim është bërë vullnetshëm dhe pasi që i ka kuptuar këto udhëzime, gjykatën i propozon që t'a miratojë këtë pranim fajësije, meqë plotësohen kushtet ligjore konform nenit 242 të KPPK-së. Ndërsa sa i përket shqyrtimit të dënimit gjykatës i propozon që fillimisht t'i ketë parasysh gjitha rrethanat lehtësuese ligjore duke përfshirë rrethanën posaqerisht lehtësuese, respektivisht pranimin e fajësisë në këtë stad të procedurës penale, pendimin e tij të sinqertë, sjelljen e tij pas aksidentit, kujdesin dhe vizitën e tij kundrejt të dëmtuarit si dhe të ketë parasysh edhe faktin se aksidenti është shkaktuar në muajin Gusht rreth orës 17:00, e që rrjedhimisht është stina e verës, është shumë nxehtë, ku drejtuesi i automjetit, tani i pandehuri, ka qenë shumë i lodhur dhe pas një ngarkesë të madhe normalisht ka rënë edhe koncentrimi me çka pa dashje ka ardhur deri te shkaktimi i aksidentit. Prandaj gjykatës i propozon që përveq rrethanave të cilat i kemi cekur t'i ketë parasysh edhe rrethanat e tjera lehtësuese, andaj të mbrojturit të tij t'i shqiptohet dënimi nën minimumin e paraparë ligjor meqenëse konsideron se në rastin konkret plotësohen kushtet ligjore për shqiptimin e një dënimi të tillë.

Pas dëgjimit të palëve, gjykata ka konstatuar se janë përmbushur kushtet nga neni 242 par. 2 të KPP-së, pasi që formoi bindjen se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban akuza, se akti akuzues nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore apo gabime teknike, andaj me këtë gjykata vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitivin e aktakuzës.

Nisur nga kjo gjendje e vërtetuar në procedurë, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit, manifestohen të gjitha tiparet e veprës penale, Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes dhe caktimit të dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 70 të KPK-së, kështu që si rrethanë posaqërisht lehtësuese gjykata mori faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza, në tërësi në seancën e shqyrtimit fillestar, duke shprehur keqardhje për veprimin e tij dhe duke i premtuar gjykatës se në të ardhmen do të jetë shumë më kujdesshëm, për të mos u përsëritur raste të tilla, sjelljen e tij pas aksidentit, gjegjësisht kujdesi me vizitat që i ka bërë të dëmtuarit, bazuar në evidencën e gjykatës, i njëjti nuk evidentohet për raste të tilla apo të tjera penale, ndërsa rrethanë të posaqme rënduese për të pandehurin gjykata gjeti dëmin e shkaktuar të dëmtuarit, i kualifikuar nga eksperti mjekësor si lëndim i rëndë trupor dhe moshën e re të tij, i cili në kohën e ndodhjes së aksidentit ka patur vetëm 17 vjet, pra ka qenë i moshës së mitur.

Andaj gjykata, për këto arsye, të pandehurin A.S, i akuzuar për veprën penale, Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-së.

, e gjykoi me dënim si në dispozitiv, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është në proporcion me veprën si dhe sjelljen e të pandehurit, dhe se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, personalitetin e të pandehurit, andaj edhe konsideron se ky dënim do të ndikojë tek i pandehuri dhe personat tjerë që të shmangen nga kryerja e veprave penale, dhe të forcojë detyrimin për respektimin e ligjit, dhe me këtë edhe të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit, i paraparë në nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Vendimi për taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 par.3 nenpar.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për kërkesën pasurore juridike, është i bazuar në dispozitën e nenit 462 të KPP-së.

Bazuar në të lartëcekurat, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**  
**DEGA KAÇANIK**  
**2023:282738 datë 30.04.2024**

Sekretarja Juridike,  
Indira Beqa

Gjyqtarja,  
Zajrete Muhaxheri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.